



**Kompania Rajonale e Ujësjetës**  
Regional Water Supply Company  
Regionalna vodovodna kompanija

KRU "GJAKOVA" Sh.A. Gjakovë		
15.03.2019		

Bordi i Drejtoreve i KRU "Gjakova" SHA bazuar në kompetencat komform nenit 7 paragrafi 2 i Statutit të KRU "Gjakova" Sh.A. si dhe kërkesat që dalin nga Neni 34.3 i Ligjit Mbi Ndërmarrjet Publike në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_, me vendimin nr. \_\_\_\_\_, aprovoi këtë:

Miraton:

## RREGULLORE PËR PAGAT

### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Kjo Rregullore përcakton:

1.2. Rregullat për përcaktimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjes publike KRU "Gjakova" Sh.A.-Gjakovë

#### Neni 2 Përkufizime

1. Në këtë Ligj shprehjet/fjalët kanë këtë kuptim:

1.1. "Paga bazë", është komponenti kryesor apo i vetëm i pagës, që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Kompleksiteti është rezultat i kombinuar i përgjegjësisë, rëndësisë dhe lirisë të vendimmarrjes, vështirësisë dhe rrezikshmërisë në kryerjen e detyrave në atë funksion, pozitë apo grade, si dhe kufizimeve që shoqërojnë punën;

1.2. "Pagesa shtesë", janë pagesat të cilat i shtohen të ardhurave bazë të përcaktuara me Ligjin e Punës në fuqi në Kosovë.

1.3. "Grupi i pagës", përbëhet nga grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti, që përfitojnë të njëjtën pagë bazë;

### **Neni 3** **Parimet e sistemit të pagave**

1. Pagat bazohen në parimet e përcaktuara, si vijon:

- 1.1 I punësuar i ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, ë pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit .
- 1.2 Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.
- 1.3 Punëdhënësi duhet t'i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera.
- 1.4 Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhet përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç'rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra.

## **KAPITULLI I** **PAGA E TË PUNËSUARVE**

### **Neni 4**

#### **Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera**

1. Paga bazë e të punësuarve në KRU''Gjakova'' Sh.A. është ajo pjesë e pagës që përfiton i punësuar për punën e kryer në një pozitë të caktuar.
2. Paga bazë e të punësuarve përcaktohet nga Grupi i Pagës të cilës i përket sipas **Shtojcës nr. 1** bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore .
3. Pagat në Kosovë paguhet sipas valutës zyrtare në Euro (€).
4. Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.

### **Neni 9**

#### **Paga bazë e punonjësit**

1. Paga bazë e të punësuarit është ajo pjesë e pagës që përfiton i punësuar për punën e kryer në një pozitë të caktuar.
2. Paga bazë e të punësuarit përcaktohet nga Grupi i Pagës të cilës i përket grupi sipas Shtojcës nr. 1 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse të kësaj Rregullore .
3. Klasifikimi i një pozite të caktuar pune sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet në Rregulloren e Organizimit dhe Sistematizimit të Detyrave të Punes ne KRU ''Gjakova'' .

### **Neni 5**

#### **Shtesat për ngarkesat e posaçme në punë**

1. Të punësuarit kanë të drejtë në shtesat për ngarkesat e posaçme në punë ,ndikimin negativ të ambientit ,reziqet në punë si dhe për punë të pa përshtatshme për punëtorin
2. Shtesat llogariten vetëm për kohën gjatë së cilës i punësuar i ka punuar në kushtet me të

cilën i takon shtesa.

3. Bazë për caktimin e shtesave ,është paga bazë e të punësuarit ,me orar të plotë të punës
4. Shtesat nga paragrafi i parë i këtij neni nuk llogariten si shtesë e posaçme në rastet kur kushtet e punës në të cilat punohet janë marrë parasysh në vlerësimin e pagës për punë tipike
5. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.
6. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
  - 6.1 20 % në orë për kujdestari;
  - 1.2 30 % në orë për punë gjatë natës;
  - 6.4 30 % në orë për punë jashtë orarit;
  - 6.5 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
  - 6.6 50 % përqind në orë për punë gjatë gjatë fundjavës .
7. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra- tjetrën.
8. I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi.
9. Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të Kompanisë.

#### **Neni 6**

#### **Paga në bazë të suksesit në punë**

1. Bazat për caktimin e suksesit në punë janë ;kuantiteti , ekonomizimi në punë , kreativiteti dhe inovacionet .
2. Suksesi në punë vlerësohet individualisht apo në mënyrë grupore ,sipas kritereve të njohura para fillimit të punës .

#### **Neni 7**

#### **Shtesa për përvojën në punë**

Të punësuarve ju njihet e drejta e shtesës për përvojën në punë 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës në punë .

#### **Neni 7**

#### **Kompensimi i pagës**

1. I punësuari ka të drejtë për kompensim në pagë, në rastet si në vijim:
  - 1.1. gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet;
  - 1.2. gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;
  - 1.3. gjatë aftësimin dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar,
  - 1.4. gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

#### **Neni 8**

### **Kompensimi i pushimit mjekësor**

2. I punësuarit në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës.
3. I punësuarit ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor që është si pasojë e lëndimit ose sëmundjes profesionale në punë e cila ndërlidhet me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për punëdhënësin me kompensim prej 70 % të pagës së tij.
4. I punësuarit ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor sipas paragrafit të këtij neni në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune.
5. Paga për kompensimin e pushimit mjekësor bie mbi punëdhënësin.
6. Të drejtat e përcaktuara sipas këtij neni mund të parashihen edhe me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm, por në asnjë rast nuk duhet të jenë më të ulëta se sa të drejtat e parapara me këtë ligj.

### **Neni 9**

#### **Kompensimi i transportit për punëtorët e bartur në një vend tjetër të punës**

Në raste të sistemimit të punëtorëve nga një vend në vendin tjetër të punës nga Neni 17 pika 3 e Ligjit të Punës, punëdhënësi kompenson të gjitha shpenzimet e transportit publik të të punësuarit.

### **Neni 10**

#### **Kompensimi në rast të pensionimit**

I punësuarit me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej 3 paga mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit.

### **Neni 11**

#### **Kompensimi i ushqimit gjatë punës**

1. Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës prej 8 orëve për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është tre euro e pesëdhjetë cent (3.5) Euro.
2. Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës.
3. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagesën e ushqimit si në pikën 1 të këtij neni.

### **Neni 12**

#### **Kompensimi për shkak shkollimit të punësuarve**

1. Të punësuarit kanë të drejtë të shkollohen, për dobi personale dhe në interes të punëdhënësit.
2. Nëse punëdhënësi i dërgon në shkollim të punësuarin, ata lidhin kontratën adekuate me veti.

- 2.1 Nëse shkollimi është i organizuar jashtë orarit të punës ,koha e shkollimit numërohet si pjesë e orarit të punës dhe i punësuari ka të drejta të njëjta sikurse gjatë punës .
- 2.2 Nëse shkollimi është i organizuar jashtë orarit të punës ,për të drejtat e të punësuarit vendos punëdhënësi.

### **Neni 13**

#### **Kompensimi i shpenzimeve të shkollimit dhe ditët e lira**

1. Të punësuarit që dërgohen në shkollim ,në interes të punëdhënësit ,nga punëdhënësi i mbulohen këto shpenzime të shkollimit :
  - 1.1 Shpenzimet e udhëtimit
  - 1.2 Shpenzimet e shkollimit
  - 1.3 Shpenzimet e ushqimit
  - 1.4 Shpenzimet e banimit
  - 1.5 Krahas ditëve të lira ,i punësuari ka të drejtën në ditë të lirë edhe në ditën e provimit .
2. Të drejtë në dit të lirë nga paragrafi paraprak ,i punësuari e ka vetëm kur hynë herën e parë në provim.
3. Ditët e lira të punës për shkollim caktohen në pajtim me kontratën e veçante ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit ,në bazë të kohëzgjatjes dhe llojit të shkollimit .
4. I punësuari që shkollohet në interes të punëdhënësit dhe dërgohet në shkollim nga punëdhënësi ka të drejtë të caktohet në vendin e punës në pajtim me shkallen e shkollimit të përfituar në bazë të kontratës .
5. Nëse punëdhënësi nuk përmban obligimet e parapara me Kontratën e shkollimit ,i punësuari është i liruar nga detyrimet e veta ,të përcaktuara me kontratë mbi shkollimin .Në rast se i punësuari nuk i përmbush detyrimet e veta në bazë të kontratës mbi shkollimin ,duhet t'ia kthej punëdhënësit të gjitha shpenzimet e shkollimit.

### **Neni 15**

#### **Ndihma solidare me rastin e vdekjes se punëtorit**

Ndihma solidare të punësuarit do ti paguhet për rastet ; Në rast të vdekjes së punëtorit kanë të drejtë në ndihmën solidare të një page, nga mesatarja e të ardhurave personale të të gjithë punëtorëve në kompani.

### **Neni 16**

#### **Kompensimi i pushimit të lehonisë**

1. Femra e punësuar gëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë.
2. Me prezantimin e certifikatës mjekësore femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në dyzetepesë (45) ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej njëzetetë (28) ditëve para datës kur pritet të lindë, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë, nëse punëdhënësi mendon se femra e punësuar nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e saj.
3. Gjjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me

4. kompensim 70% të pagës bazë.
5. Tre (3) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë.
6. Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre (3) muaj të tjera pa pagesë.

#### **Neni 17**

#### **Kompensimi i lëndimit në punë**

1. Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.
2. Ministria nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë.

#### **Neni 18**

#### **Kompensimi i punëtorëve me gjendje të rëndë shëndetësore dhe të pa shërueshme**

Deri në zgjidhjen e çështjes sociale, për punëtorët me gjendje shëndetësore të rëndë dhe pashërueshme, të konstatuar nga mjeku specialist i sëmundjes përkatëse, i behet kompensimi të ardhurave në kohëzgjatje deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune ,prej 70 % të pagës së tij.

#### **Neni 19**

#### **Kompensimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor**

3. Të punësuarit nuk mund t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor .
4. I punësuarit që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punëmarrësit, apo kompensim me të holla.
5. Lartësia e kompensimit nga paragrafi 2. i këtij neni, caktohet varësisht nga kohëzgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuarit i realizon për muajin kur kompensohet .

#### **Neni 20**

#### **Mungesa nga puna me pagesë**

I. I punësuarit ka të drejtë të mungojë nga puna me kompensim të pagës:

- 1.1. pesë (5) ditë në rast të martesës së tij;
- 1.2. pesë (5) ditë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes;
- 1.3. tri (3) ditë për lindje të fëmijut;
- 1.4. Një ditë pune me rastin e ndërrimit të vendbanimit të punëtorit ,gjegjësisht familjes së punëtorit në
- 1.4. Deri në 3 ditë pune për fatkeqësi elementare
- 1.6. një (1) ditë pune për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut.

## Neni 21

### Kompensimin e shpenzimeve te udhëtimit zyrtar

1. Punëmarrësve të K.R.U "Gjakova", iu takon kompensimi i shpenzimeve për udhëtim zyrtar kur kryejnë pune ne kuadër te detyrave te tyre te punës për K.R.U "Gjakova"SH.A-Gjakovë.
2. Drejtori menaxhues vendos për personat te cilët do te udhëtojnë zyrtarisht ne kuadër te projekteve ose nevojave te tjera qe paraqiten ne kuadër te afarizmit dhe politikave zhvillimore te K.R.U "Gjakova"SH.A-Gjakovë.
3. Urdhëresa për udhëtim zyrtar duhet te përmban këto shënime:
  - emri dhe mbiemri i punëmarrësit qe udhëton
  - punët dhe detyrat e punës qe duhet te kryhen,
  - vendi dhe shteti ku duhet udhëtuar,
  - koha e nisjes dhe kohëzgjatja e udhëtimit,
  - mjete i udhëtimit qe do te përdoret për udhëtim,
  - lartësia e akontacionit dhe te dhënat tjera eventuale te nevojshme.
4. Punëdhënësi K.R.U"Gjakova"SH.A-Gjakovë, do t'i paguaj punëmarrësit shpenzimet për udhëtim zyrtar të cilat përfshijnë transportin , fjetjen dhe shujtat për udhëtime pun.
5. Duhet të plotësohen kushtet që të kualifikohet shpenzimi për punë si:
  - Udhëtimi për punë duhet të jetë i autorizuar me shkrim nga niveli i duhur menaxheria;
  - Duhet të ceket qartë qëllimi i udhëtimit për punë
  - Kërkesa për udhëtim duhet të jetë në harmoni me politikat e pagesave të udhëtimit të punëdhënësit.

## Neni 22

### Kompensimi i shpenzimit për fjetje;

Fjetja jashtë Kosovës kompensohet sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. MSHP 2004/07 që varet nga shteti ku behet fjetja.

## Neni 23

### Shpenzimet e transportit

1. Shpenzimet e transportit të udhëtimit zyrtar kompensohen ne vlerën 100 % te shpenzimeve faktike të dëshmuara me biletat e transportit publik ose në formë tjetër.
2. Nëse punëmarrësi e shfrytëzon automjetin privat për udhëtim zyrtar i paguhet kompensimi te shpenzimeve te derivateve 0,16 € për kilometër

## Neni 24

### Kompensimi i shpenzimit për shujta jashtë Kosovës

1. Shujta jashtë Kosovës kompensohet sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. MSHP 2004/07 që varet nga shteti ku janë siguruar ushqimet.

2. Ne baze te urdhëresës për udhëtim jashtë vendit mund te paguhet akontacioni ne lartësi te shpenzimeve te përlllogaritura.
3. Llogaritjes se shpenzimeve te udhëtimit i bashkëngjiten:a)Urdhëresa për udhëtim zyrtar dhe provat mbi shumen e paguar për shpenzimet e tërësishme te hotelit, biletës se udhëtimit, dhe shpenzimeve te tjera te pranueshme.
4. Ne afat prej 48 orësh pas kthimit ne pune punëmarrësi duhet te paraqes raportin me shkrim për kryerjen e detyrave ne ketë udhëtim zyrtar.
5. Faturat për harxhime gjate udhëtimit duhet t`i paraqes ne afat prej tri ditësh.

#### **Neni 25**

#### **Shpenzimet e sigurimeve mjekësore, vizave, thirrjeve telefonike**

Kur ato janë te domosdoshme bien ne barre te K.R.U “Gjakova”SH.A-Gjakovë

#### **Neni 26**

#### **Pjesëmarrja ne seminare, kongrese e takime**

Te tilla te ngjashme, mund te bëhen vetëm ne raste kur te njëjtat organizohen ne kuadër te lëmit te ujit te pijes,kanalizimeve dhe ujerave te zeza.

1. Punëdhënësi mund t`i kompensoj shpenzimet e qirasë për ndonjërin apo grupe te punëmarrësve për te cilët shprehet nevoja e theksuar (kuadro). Këtë nevojë e përcakton menaxhmenti i kompanisë. Këto shpenzime mund te jene te përkohshme dhe mund te zgjasin me se gjati 3 muaj.
2. Vlera maksimale për një këst mujore te qirasë mund te jete ne lartësinë ne një page mesatare mujore ne nivel te punëdhënësit.

#### **Neni 27**

#### **Shpenzimet për ndihma solidare financiare pa obligim kthimi**

Ne rast te sëmundjes se rende te punëmarrësit, apo fatkeqësive natyrore a ne baze te kërkesës se te njëjtëve mund t`iu epet pa kthim ndihma solidare financiare te cilën vlere e përcakton Ekzekutivi i kompanisë, varësisht nga rasti dhe gjendja financiare e ndërmarrjes, por kjo nuk mund te kaloj me shume se 2 paga mujore mesatare te punëdhënësit.

#### **Neni 28**

#### **Kompensimi i lëndimit në punë**

1. Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t`ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme.
2. Ministria nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë.



## Neni 29

### **Shpenzimet me rastin e festave të fund vitit ,fetare dhe kombëtare dhe donacionet për palët e treta**

1. Varësisht nga gjendja financiare e kompanisë dhe ne pajtim me vendimin e menaxhmentit të kompanisë, pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve të punësuarve të kompanisë mund të ndahen mjete financiare me rastin e festave fetare, kombëtare , festave të fund vitit dhe për rastin e përgatitjeve për fillim-vitin e ri shkollor.
3. Kompania mund të jete donator i ndonjë projekti sipas kërkesës së palëve të treta (individë ose persona juridik), por ky donacion nuk mund të kalojë vlerën e një page mujore mesatare të punëdhënësit.
4. Kompania mund të jete donator i ndonjë projekti të ndonjë OJQ-je ose grupe të tjera të organizuara interesi si sportiv, edukativ, me karakter garues etj, për realizimin e
5. ndonjë projekti të rëndësishëm, por ky donacion nuk mund të jete më i madh se 10 % e vlerës së përgjithshme të vet projektit të parapare.

## Neni 30

### **Kompensimi i pagës gjatë largimit të përkohshëm**

1. Gjatë kohës së largimit të përkohshëm nga puna, sipas nenit 73 të Ligjit të Punës , të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50%.
2. Largimi i përkohshëm nga puna sipas nenit 73 të Ligjit të Punës, mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë Kontratën e Punës.

## Neni 31

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj , dhe me aprovimin e kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja mbi Shpenzimet e Parasë në KRU" Gjako" Sh.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve



Fatos Koshi

Salary Scale for KRU "Gjakova" /Struktura e Pagave ne KRU"Gjakova" Sh.A.

Grade	Description	Range				Percent Spread Between	
		Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	% nryryshimit	Min - Max diff.	Nr. Punonjeseve
G1	Worker / Punëtor niveli para	€ 395.00	€ 485.00	€ 440.00	15%	11%	58
G2	Senior Worker / Punëtor I mesem /Punëtor I larte	€ 485.00	€ 530.00	€ 507.50	8%	5%	115
G3	Unit Specialist / Specialist njesile	€ 530.00	€ 565.00	€ 547.50	8%	3%	21
G4	Senior Specialist / Specialist I larte	€ 565.00	€ 620.00	€ 592.50	8%	5%	36
G5	Asistent Manager / A. Menaxher	€ 620.00	€ 660.00	€ 640.00	9%	3%	9
G6	Engineer / Financiar / Menaxher /Specialiste te larte	€ 735.00	€ 735.00	€ 697.50	15%	6%	18
G7	Director of Department /Dreitor Departamenti	€ 735.00	€ 870.00	€ 802.50	15%	9%	3
G8	Director of Department / H.Manager / Dreitor Departamenti / Zvrtar I larte	€ 870.00	€ 900.00	€ 925.00	46%	6%	5
G9	Executive / Kryeshtefi / Ekraktivy	€ 1,250.00	€ 1,460.00	€ 1,355.00		8%	1

GRADE	KODICENTI	SHEMIME	
		INCHIZE	Worker / Punëtor niveli para
	395	1.652719665	395-485
	395	1.652719665	
	418	1.748953975	
	418	1.748953975	
	395	1.652719665	
	441	1.843933054	
	418	1.748953975	
	441	1.845188285	
	441	1.843933054	
	463	1.938493724	
	463	1.937238494	
	463	1.937238494	
	463	1.937238494	
	463	1.938493724	

GRADE	KODICENTI	SHEMIME	
		INCHIZE	Senior Worker /Punëtor I mesem /Punëtor I larte
	485	2.029288703	485-530
	485	2.029288703	
	485	2.029288703	
	485	2.029288703	
	485	2.029288703	Poshte e re
	485	2.029288703	
	485	2.029288703	

LEXUESHPERADRES TE FATURAVE (18)	508	2.125523013	
LEXUESHPERADRES TE FATURAVE ARNETUES (18)	508	2.125523013	
ZYRTAR TE KONTABILITETIT (MATERIALI) (1)	485	2.029288703	
ELEKTRICIST - MIRËMBAJTJA DHE ZHVILLIMI (2)	509	2.127615063	
OPERATORI EKS-KAVATORIT (4)	509	2.127615063	
LEXUESI I INSTITUCIONEVE DHE BIZNESEVE (3)	509	2.127615063	
MONTER (13)	509	2.127615063	
PËRGRUEJËS PËR AUTOPARK (1)	509	2.127615063	
VOZITËS I AUTOMJETIT TË (Kryeshtetit Elektrikëve) (1)	509	2.127615063	
ZYRTARI LGIS (2)	509	2.127615063	
ASISTENT TEKNIK NË ZYRËN LGJORE (1)	509	2.127615063	
ASISTENTE NË NJESIE E AUDITIMIT TE BRENDSHËM (1)	509	2.127615063	
MIRËMBAJTËS I MEKANIKES NË SF (1)	486	2.033054393	
MIRËMBAJTËS NDËRTIMOR (2)	486	2.033054393	
MANIPULUES DHE MIRËMBAJTËS I OBJEKTEVE/KANALEVE (2)	486	2.033054393	
MIRËMBAJTËS I ELEKTRIKËS NË SF (1)	486	2.033472803	
MANIPULUES DHE MIRËMBAJTËS I ELEKTRIKES/DISPEJERISE (4)	486	2.033054393	
VOZITËS TE AUTOMJETIT (3)	486	2.033054393	
SHOFER I AUTOGJISTERNËS (2)	497	2.080334728	
SHOFER I MINICISTERNËS (1)	497	2.080334728	

G2

SHËNIME		KODI	
PAGA BAZË	ANALIZË	Unit Specialist / Specialist njësie	
		531	2.221757322
DEPONIER (2)		531	2.221757322
FURNIZUES (1)		531	2.221757322
REFERENTE NË QENDREN E THRRJEVE (1)		531	2.221757322
KRYEPUNËTOR I GRUPIT TE MIREM. SE UJESJELLESIT FSHATQYTET(3)		531	2.221757322
			Posit e re
KRYEPUNËTOR I GRUPIT TE KANALIZIMIT DHE UJERAVE TE NDOTURA PER GJAKOVE - RAHOVECI(1)		531	2.221757322
KRYEPUNËTOR NDËRRIM NË NJESIE E TRAJTIMIT TE UJIT (5)		531	2.221757322
DETEKTUES I RRJEDHJEVE NE RRJET TE UJESJELLESIT (2)		553	2.313807531
ASISTENT I FATURIMIT (1)		531	2.221757322
SHËF I NJESISE SE LEXIMIT TE UJEMATESVE (2)		554	2.316736402
ASISTENTIE I NJESISE PER BANKA DHE NJESITE MONETARE(1)		531	2.221757322
KALIBRUES I UJEMATESVE TE KONSUMATOREVE (2)			Posit e re

G3



SHENIME		SHENIME	
PAGA/INDZE	KUPOSICENTI	PAGA/INDZE	KUPOSICENTI
			Engineer / Financiar / Menaxher / Specialiste te larte 660-735
		700	2.928870293
	MENAXHERI SEKTORIT TE ZHVILLIMIT (1)	700	2.928870293
	SHEF I NJESISE SE GJEDDEZISE (1)	700	2.928870293
	SHEF I NJESISE TE ELEKTROTEKNIKES TENSIONI J ULETI(1)	700	2.928870293
	SHEF I NJESISE TE ELEKTROTEKNIKES TENSIONI I LARTE (1)	700	2.928870293
	SHEF I NJESISE TE SHERBIMEVE MEKANIKE (1)	700	2.928870293
	HIDROINZHINIER (2)	700	2.928870293
	ZYRTAR PER PROJEKTIM ZHVILLIM (2)	700	2.928870293
	UDHHEQES TE NJESIVE OPERATIVE/ RAHOECIPRIZREN (2)	700	2.928870293
	SHEF I NJESISE OPERATIVE-GJAKOVE (1)	700	2.928870293
G6	MENAXHERI SEKTORIT I MARREDHENIEVE ME KONSUMATOR (1)	667	2.789539749
	MENAXHERE E SEKTORIT TE KONTABILITETIT (1)	667	2.789539749
	MENAXHERI OPERIMIT TE UJIT (1)	700	2.928870293
	MENAXHERI SEKTORIT TE UJRAVE TE NDOJTURA (1)	700	2.928870293
	INZHINIER I UJRAVE TE NDOJTURA (1)	700	2.928870293
	MENAXHERE E SEKTORIT TE SHITES (1)	667	2.789539749
	MENAXHERI SEKTORIT TE PRODHIMIT TE UJIT(1)	667	2.789539749
	MENAXHERI ABETEVE (1)	700	2.928870293
	MENAXHERE E SEKTORIT FINANCIARE (1)	667	2.790794979
	AUDITORI I BRENDSHERI (1)	667	2.790794979

SHENIME		SHENIME	
PAGA/INDZE	KUPOSICENTI	PAGA/INDZE	KUPOSICENTI
			Director of Department /Drejtor Depaertamenti 735-870
G7	DREJTORI DEPARTAMENTIT TE BURIMEVE NJEREZORE (1)	735	3.075313808
	DREJTORI DEPARTAMENTIT TE ADMINISTRATES (1)	735	3.075313808
	DREJTORI DEPARTAMENTIT TE IT (1)	735	3.075313808
	DREJTORI DEPARTAMENTIT TE PROKURIMIT (1)	735	3.075313808

SHENIME		SHENIME	
PAGA/INDZE	KUPOSICENTI	PAGA/INDZE	KUPOSICENTI
			Director of Department / H.Manager / Drejtor Depaertamenti / Zyrtar te larte 870-990
	KRYE ZYRTARI FINANCIAR (1)	870	3.640585774
G8	SEKRETARE E KORPORATES / KSHILLTARI PERGJITHSHEM (1)	870	3.640585774
	DREJTORI NJ. PER AUDITIM TE BRENDSHME (1)	870	3.640585774
	DREJTORI DEPARTAMENTIT KOMERCIAL (1)	870	3.640585774
	DREJTORI DEPARTAMENTIT TEKNIK (1)	970	4.058577406

SHENIME		SHENIME	
PAGA/INDZE	KUPOSICENTI	PAGA/INDZE	KUPOSICENTI
G.B	KRYESHEFI EKZEKUTIV (1)	1,458	6.09916318
	Executive / Kryeshafi Ekzekutiv		1,458